



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, ish - hotel “Drini”, Tiranë

Tel: 04 2268141; Fax: 04 2268142

Nr. 252/4 Prot

Tiranë, më 04.10.2017

V E N D I M

Nr. 202, datë 04.10.2017

“Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për këtë arsye,

nisur nga rëndësia e problematikave të parashtruara në informacioneet e ardhura në lidhje me parregullsi gjatë administrimit të shërbimit civil në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe mbi propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:
 - **Altin Shumeli** **Drejtor i Mbikëqyrjes**
 - **Zamira Mujali** **Inspektore**
 - **Matilda Idrizaj** **Inspektore**
3. Mbikëqyrja do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt në datën **05.10.2017** dhe do të vijojë procesi i grumbullimit të të dhënave, deri në datën **11.10.2017**. Nëse

gjatë fazës së përpunimit të të dhënave lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.

4. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, nën drejtimin metodologjik të Drejtorit të Përgjithshëm, do të vijojë procesin me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projektraportit të mbikëqyrjes. Projektraporti do të përfundojë në datën **13.11.2017** dhe pasi t'i paraqitet Komisionerit për miratim, më tej, do t'i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t'u njohur me gjetjet, duke i lënë 10 ditë kohë për të përgatitur observacionet.
5. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve e në datën **30.11.2017**, do t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
6. Nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes nuk arrihet të respektohen afatet e vendosura, drejtuesi i grupit të punës duhet të kërkojë zgjatje afati tek Komisioneri, duke argumentuar edhe arsyet për mospërfundimin e procesit në afat.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të ligjit nr.44/2015 “*Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA